



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 400/4 Prot.

Tiranë, më 09.05.2019

V E N D I M

Nr. 45, datë 09.05.2019

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimë shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 97, datë 03.12.2018 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimë e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 876/1, datë 03.12.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 876/2, datë

03.12.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë”, i është njoftuar Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore përfshihen për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikuar në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 78), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 400 prot., datë 08.04.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 47 prot., datë 19.04.2019, “Dërgohet i firmosur projekt raporti”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personi përgjegjës, duke qenë dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar

situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike dhe eprori direkt për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në rastin e punonjësit *****, duhet të kryejnë veprimet si mëposhtë:
 - ✓ Të ndryshohet akti administrative nr. 3282/24, për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin *****, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, I ndryshuar, (*data 26.02.2014*), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit të tij është më pak se 1 vit.
 - ✓ Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
 - ✓ Të nxjerrë për nëpunësin vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Për këtë vendim të njoftohet Qendrar Transferimit të Teknologjive, Korçë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA